



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar”.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar.”

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Artur Roshi dhe Krenar Ryçi.

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Financave dhe Ekonomisë

Elton Haxhi - Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë

Elvis Koçi - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Niko Lera - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Agim Muslia - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Flogers Broqi - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

Mikeljan Shkalla - përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Sot në rendin e ditës kemi tri ligje, disa ndryshime në ligjin “Për taksën e biznesit”; disa ndryshime për ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, që kanë të bëjnë kryesisht me luftën kundër terrorizmit dhe me kërkesat e Manival-it në lidhje me frenimin e pastrimit të parave në Republikën e Shqipërisë me procedurat sa më strikte parandaluese, si dhe disa ndryshime dhe shtesa në ligjin “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të kërkuara po nga Manivali.

Relatore për ligjin për regjistrimin e biznesit, është zonja Evis Kushi, për ligjin për procedurat tatimore është zonja Antoneta Dhima, për ligjin për masat kundër terrorizmit, të ndryshuar, është zoti Roland Xhelilaj.

Të ftuar në komision janë zonja Anila Denaj, ministre e Financave dhe Ekonomisë, zotin Elton Haxhi (zotin Haxhi, nuk po e shoh), zoti Elvis Koçi, të cilin nuk e di se çfarë detyre ka se nuk ma kanë prezantuar këtu, zoti Niko Lera, mungon, zoti Agim Muslia, zoti Flogers Broqi dhe zoti Mikeljan Shkalla.

Ju falënderoj për prezencën tuaj!

Fillojmë me relatimin e ligjit të parë “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për regjistrimin e biznesit”, të ndryshuar”.

Evis Kushi – Përshëndetje!

Faleminderit, kryetar!

Projektligji që po shqyrtojmë vjen si paketë së bashku me projektligje të tjera në kuadër të përmbushjes së rekomandimeve të Këshillit të Europës, nëpërmjet Komitetit të Ekspertëve lidhur me masat që duhet të marrë vendi ynë sa i takon luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Nga analiza që i është bërë situatës konkrete për regjistrimin e bizneseve janë konstatuar disa problematika, të cilat synon t’i zgjidhë ky projektligj.

Së pari, konstatojmë që mospërditësimi në kohë reale i të dhënave që lidhen me ortakun në biznes dhe me gjendjen e ortakërisë ka sjellë mungesë transparence.

Së dyti, nuk ka masa shtrënguese apo penalizuese për ato biznese që nuk përditësojnë të dhënat në lidhje me gjendjen dhe strukturën e ortakërisë.

Së treti, në ligj mungon e drejta e administratorit, të personit juridik për të regjistruar biznesin apo për t’i përditësuar këto të dhëna.

Këto janë tri problematikat e konstatuara, të cilave ky projektligj i jep zgjidhje dhe plotëson katër synime kryesore.

Së pari, përfitimin në kohë në regjistrin tregtar të të dhënave lidhur me ndryshimet në ortakëri dhe strukturën e ortakërisë të personit juridik.

Së dyti, rritjen e transparencës në lidhje me këto të dhëna.

Së treti, përfshirjen e administratorit të personit juridik për kryerjen e regjistrimit fillestar të personit juridik.

Së katërti, parashikimin e sanksioneve apo të penalteteve, të cilat lidhen me mosreflektimin në kohë reale të ndryshimeve.

Unë mendoj se ky projektligj është i dobishëm, sjell masa të dobishme, të nevojshme, prandaj u sugjeroj të gjithë kolegëve ta miratojmë projektligjin, ndërkohë kur të kalojmë te seanca e pyetjeve kam një paqartësi, gjë të cilën do t'ia kërkoj më pas ministrisë, si dhe 2-3 ndryshime të vogla që lidhen me teknikën legislative, por këtë gjë do ta bëjmë kur ta votojmë projektligjin nën për nen.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zonja Ministre e ka fjalën.

Anila Denaj – Përsëndetje!

Faleminderit, zoti kryetar!

Ministria përfaqësohet nga zoti Mete, i cili ka zëvendësuar zotin Haxhi, i cili nuk ndodhet në Shqipëri, si dhe zoti Kuçi, i cili është drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, efektive prej javës së kaluar.

Sa i takon paketës, në kuadër të procesit të vlerësimit nga Komiteti Manival i Këshillit të Europës me publikimin e raportit të vlerësimit, Shqipërisë i është lënë një vit kohë për përmbushjen e rekomandimeve dhe adresimin e rekomandimeve të evidentuara. Nga këto rekomandime, rekomandimi për rritjen e mëtejshme të transparencës lidhur me ndryshimet e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik, si dhe rekomandimi për rritjen e gjobave të vendosura sipas ligjit nga QKB është pjesë e diskutimit të këtij projektligji, i cili parashikon që aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë.

Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit faktik të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 000 lekë.

Ndërkohë, për shoqëritë aksionare, shoqëria së bashku me bilancin vjetor kontabël dhe raportin e auditimit njofton listën e plotë të aksionerëve të regjistruar me të dhënat e tyre të identifikimit për aksionet normative, si dhe numrin e përgjithshëm të të gjitha aksioneve të saj dhe në mungesë kundërvajtja administrative dënohet me gjobë 100 000 lekë.

Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit, ose nga administratori i shoqërisë, ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimet e tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre.

Ndërkohë, në zbatim të ligjit për shoqëritë tregtare është bërë edhe një ndërhyrje për rregullimin e dispozitës ekzistuese me anë të së cilës jepet mundësia që edhe administratori të parashikohet në ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007, si një nga personat që kanë të drejtën e aplikimit për të kryer një regjistrim fillestar të personit juridik.

Këto ishin pak a shumë ato që kisha. Tani mund të kalojmë në diskutime të pyetjeve dhe të çështjeve që ju keni.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Zonja Kushi e ka fjalën.

Evis Kushi – Unë kam një pyetje që lidhet me masën e gjobës të parashikuar në këtë projektligji, e cila dukshëm është në disproporcion me penalitetet e tjera që janë në ligjin ekzistues. Pra, normalisht gjobat ekzistuese janë diku te 15 000 lekë, ndërkohë që këtu në këtë ligj parashikohet 100 000 lekë, gati 7 herë më shumë, duke ditur që parimi bazë është që gjobat duhet të jenë efektive dhe proporcionale. Cila është logjika dhe argumentet që qëndrojnë pas këtij ndryshimi kaq të ndjeshëm midis gjobave aktuale dhe kësaj që parashikohet në ligjin e ri?

Arben Ahmetaj - Po, zoti Broqi.

Flogers Broqi – Faleminderit!

Pyetja është shumë e drejtë. Për arsye të vlerësimit, por edhe të rekomandimeve të lëna nga ekspertët e Manival-it të Këshillit të Europës, një nga rekomandimet kryesore ishte se masat ndëshkuese ishin jo bindëse. Kjo është një nga pikat ku ekspertët e ministrisë së bashku me Qendrën Kombëtare të Biznesit u fokusuan për të argumentuar edhe rritjen e kësaj mase administrative. E vërteta është se masat e tjera janë vetëm prej 15 000 lekë të reja ose 150 000 lekë të vjetra, por në ligj janë të përfshira që nga viti 2009 dhe në të vërtetë të gjitha duhen riparë. Ne sot jemi në një proces rishikimi me Ministrinë e Financave dhe në Qendrën Kombëtare të Biznesit, sepse të gjitha këto masa administrative duhen riparë në mënyrë që të jenë në koherencë dhe në përputhje me ato për çka janë vendosur.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zonja Hyseni.

Edlira Hyseni – Mirëdita!

Në radhë të parë, sa i takon propozimit për ndryshimin e ligjit për regjistrimin e biznesit, do të doja t’i kërkoja, ne jemi të rinj në komision dhe do të na falni nëse nuk i dimë procedurat tamam, që së bashku me materialet të ishte edhe ligji bazën ai që po ndryshojmë. Unë e di që ligji gjendet *online*, por ligjet te ne ndryshojnë shumë shpesh, prandaj kur ne i referohemi një ndryshimi është mirë të kemi edhe ligjin bazë.

(Diskutime pa mikrofon)

Ky ishte thjesht një sugjerim.

Meqenëse të gjitha ndryshimet, që do të diskutojmë sot, por edhe ato të mbledhjes së nesërme, të cilat i referohen rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave, një plan masash, të cilin e ka ndërmarrë qeveria, mendoj se do të ishte mirë të ishim edhe në dijeni të këtij raporti për të kuptuar dosmodoshmërinë e këtyre ndryshime. Ndoshta për ju është e mirëqenë se si është logjikuar nevoja e këtyre ndryshimeve, por unë nuk jam në dijeni të këtij raporti që ka lënë këto rekomandime dhe bën të nevojshëm këto ndryshime.

Dy ndryshimet bazë që ju i bëni ligjit janë...

Arben Ahmetaj – Më falni, a keni pyetje?

Jemi në seancën e pyetjeve dhe jo të komenteve dhe të opinionëve.

A keni pyetje për ministrinë?

Edlira Hyseni – Po, kam një pyetje.

Në projektligj janë dy ndryshime kryesore. I pari lidhet me detyrimin për deklarimin e ndryshimeve të ortakërisë së sh.p.k.-ve brenda 30 ditëve. Në fakt, kjo qenë, sepse të gjitha ndryshimet që një shoqëri tregtare bën janë të detyruara të deklarohen brenda 30 ditëve në QKB. Nevoja e specifikimit vetëm për këtë lloj ndryshimi që pa dyshim është ndër ndryshimet më të rëndësishme që prek një shoqëri tregtare dhe masa penalizuese për mosbërjen e kësaj është shumë e lartë, ashtu siç tha edhe parafolësja, do të doja të kuptoja pse është gjykuar të ndryshohet vetëm kjo pikë, në një kohë që të gjitha ndryshimet që bën një shoqëri duhet të deklarohen brenda 30 ditëve. Pse është veçuar pikërisht ortakëria? Sepse në realitetin praktik në Shqipëri ndonjëherë subjektet penalizohen për neglizhencë, pakujdesi apo pamundësi të deklarimeve, sepse shpesh ata kanë ortakë persona që nuk jetojnë më dhe procedurat për transferimin e kuotave janë shumë të vështira. Pra, ndonjëherë ai 30-ditëshi bëhet shumë i vështirë për t’u aplikuar për ato subjekte, të cilat më pas do të penalizohen me një gjobë shumë të lartë për një diçka që ata e dinë përgjithësisht ose nëse kjo gjë lidhet me arsye të tjera, sa u takon rekomandimeve, dua të kuptoj arsyet.

Sa i takon ndryshimit të dytë në të cilin ju keni shtuar administratorin, besoj se bëhet për më mirë, por në praktikën e...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, bëni pyetjen!

Edlira Hyseni – Pyetja që unë kam është: a nuk mendoni që delegimi i një përgjegjësie kaq të madhe si regjistrimi fillestar i një shoqërie, i një administratori shqiptar me ortak të huaj mund të lërë vend për regjistrime apo hapje të bizneseve fiktive? Kjo gjë mund të thjeshtohet nëse një administrator i vetëm me një akt të thjesht regjistron një shoqëri tregtare, pastaj administratori...

Arben Ahmetaj – Ju lutem, ndiqni procedurën, bëni pyetjen! Më pas kur të vijnë komentet dhe doni të mbani qëndrim, mbani qëndrim, nuk bëhet pyetja si qëndrim!

Edlira Hyseni – Administratori nuk është ende administrator pa u regjistruar shoqëria, prandaj dua të di nëse i delegohet procedura e çeljes së regjistrimit të shoqërisë një administratori thjesht nga statuti? Unë nuk e di se si e keni gjykuar ju që administratori ka të drejtë të regjistrojë një shoqëri për herë të parë, sepse më duket një përgjegjësi shumë e madhe.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Kush e do fjalën nga përfaqësuesit e ministrisë?

Po, zoti Broqi.

Flogers Broqi – Faleminderit!

Sa i takon pyetjes së parë, ajo është e ndërlidhur me masën administrative, e cila është tepër e lartë, por për arsye të rekomandimeve dhe të fokusit të qeverisë u pa e nevojshme që neni 22, pika 5 të ndahej pikërisht për të mos rënduar subjektet tregtare që ushtrojnë biznes në Republikën e Shqipërisë me një masë kaq të lartë në proporcion me të tjerat.

Pra, është e logjikshme që mosdeklarimi brenda 30 ditëve i ndryshimit të selisë ose ndryshimi i administratorit, sot në ligjin aktual edhe me ndryshimet e reja masa mbetet 15 000 lekë, ndërkohë është parë e nevojshme shkëputja, detyrimi ka qenë edhe dje sa i takon ortakërisë, nga pika 5 e nenit 22, është e nevojshme pikërisht për të mos i rënduar subjektet tregtare me masë administrative për çdo lloj veprimtarie që ata duhet deklarojnë në regjistrin tregtar.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Unë kisha dy pyetje, por, meqenëse pyetja ime u përputh me atë që bëri zonja parafole, në këndvështrimin tim nuk është argument që veçimi i një aktiviteti domosdoshmërisht për t'u regjistruar të veçohet në mënyrë që të ndahet nga aktivitetet dhe detyrimet e tjera për të mos u gjobitur ose gjobitur. Sipas mendimit tim, pavarësisht se është prezantuar si paketë e rekomanduar nga Manival-i, të cilat ne i kemi kaluar në detaje, të prekësh ligjin e regjistrimit të biznesit për çek në lidhje me Manival-in, nuk më duket fort normale, aq më tepër që ky qëndrim është në një ligj tjetër.

Pra, detyrimi i biznesit për t'u regjistruar, i ortakëve për t'u regjistruar i deleguar administratorit apo jo në ndryshimet që bëjnë vazhdimisht për 30 ditë, 15 ditë apo 20 ditë është...

Të vish në komision dhe të ndryshosh ligjin për regjistrimin e biznesit... Sepse kam edhe një merak, të cilin besoj se e keni diskutuar gjatë edhe me ata që merren me thjeshtësimin e procedurave, besoj se Senida mund të më mbështesë në këtë pikë: a keni konsultuar këtë gjë, a është shtesë kjo? A është rritja e gjobës një ngarkesë plus? A është e argumentuar mjaftueshmërisht? A ka ndonjë procedurë standarde që Manivali e sjell, por sidomos nga Bashkimi European, e cila replikohet në Shqipëri, por është në Itali, është aty është këtu, është gjithandej dhe bën diferencë në luftën kundër pastrimit të parave?

Flogers Broqi – Sot në Bashkimin European është edhe *acquis communautaire* sa i përket pronarëve përfitues në të cilën Ministria e Financave, QKB-ja kanë qenë pjesë gjatë gjithë kësaj periudhe 5-mujore në të gjitha takimet me ekspertët e Manival-it, por edhe të Këshillit të Europës, si dhe me ekspertët e TAEX-it, të cilët kanë ardhur posaçërisht për konsultimin ose trajnimin e juristëve...

Arben Ahmetaj – Emrin, ju lutem!

Flogers Broqi – Flogers Broqi.

Arben Ahmetaj – Këtë gjëra i di unë, i kam bërë unë, i ke bërë ti, i ka bërë ministrja, i ka bërë zoti Angjeli, por jam duke folur konkretisht. A mund të më referoni se ku kemi qenë ne ndryshe nga direktiva e sugjeruar ose nga kërkesa e Manival-it?

Flogers Broqi – Sot, Republika e Shqipërisë nuk ka asnjë masë rregullative ose ligjore sa i përket regjistrimit të pronarëve përfitues. Rekomandimi kryesor është ngritja e Regjistrit Kombëtar të Pronarëve Përfitues...

Arben Ahmetaj – Kjo është diçka tjetër. Regjistrimi i pronarëve përfitues është një procedurë administrative e domosdoshme, t'i ndajmë gjëra, ndërsa domosdoshmëria e regjistrimit, të lutem, mos më thuaj që nuk është në asnjë legjislacion, sepse është në legjislacion, sepse duhet të jemi korrekt me komisionin. Janë dy gjëra të ndryshme Regjistri i Ortakërisë është një gjë komplet tjetër dhe është e domosdoshme, shtesa dhe theksimi i detyrimit për t'u regjistruar mos më thuaj që nuk është, sepse është në një legjislacion tjetër.

Më pas, nëse ne mendojmë se e zgjidhim këtë me gjobë, nuk mendoj ta zgjidhim me gjobë duke e shtuar gjobën. Gjithsesi këto janë qëndrime, të cilat do t'i kalojmë nen për nen dhe nuk mendoj se shtesa do të bënte ndonjë diferencë në ligj, megjithatë logjika e qeverisë dhe e ministrisë do të mbështetet nga komisioni.

Zoti Roshi, ju lutem, bëni pyetjet tuaja!

Artur Roshi – Zonja Ministre, tek afati i regjistrimit prej 30 ditësh të ortakut, nuk mendoj të jetë i mjaftueshëm. Dua të di nëse ky afat ju duket i mjaftueshëm juve?

Kam parasysh, për shembull, një njeri që kryen një biznes dhe është i sëmurë ose ka procese teknologjike që nuk i ndërpret dot, për shembull në një furrë, pra ai që bën biznes është i zhytur në rutinën e ditës së biznesit të tij dhe mund ta neglizhojë këtë 30-ditëshin. A nuk ju duket pak i shkurtër ky afat kohor për një që bën biznes?

Anila Denaj -Faleminderit!

Afati ka qenë 30 ditë dhe është 30 ditë. Mendoj se është një afat i pranueshëm, për më tepër që është në fokus të rutinës së çdo drejtuesi, çdo aksioneri, dhe për më tepër ai mundet ta delegojë. Këtë detyrë ka administratori dhe këtë ia njeh ligji. Nuk mendojmë se zgjatja e afatit me 45 ditë mund të zgjidhte ngërçin e çështjes rutinore. Është në fokus dhe duhet të jetë në fokus të aksionerëve. Mendoj se afati 30 ditë duhet të qëndrojë.

Arben Ahmetaj- A keni mendim tjetër?

Vullnet Sinaj – Unë vij nga biznesi dhe më duken të kota këto diskutime, sepse biznesmeni e gjen kohën për t'u regjistruar dhe paguar gjobën. 100 mijë lekëshi i gjobës është për ta imponuar që ai të shkojë e të regjistrohet atje. Unë mendoj se nuk duhet të merremi më me këtë, sepse kemi gjëra më të mëdha për biznesin.

Artur Roshi - Vendorsja e gjobës prej 100 mijë lekësh të rinj është një praktikë që do të ndikojë në përkeqësimin e klimës së biznesit. Kemi të freskët ikjen e mbi 100 bizneseve nga vendi ynë për shkak të kësaj klime. Pra, unë mendoj që në mënyrë të tërthortë me rritjen e këtyre gjobave ne ndikojmë ose përkeqësojmë klimën e biznesit në vend. Propozimi im konkret, nëse shihet i arsyeshëm, është të fokusohemi te gjobat simbolike, pra të kenë një karakter vetedukues. Ne duhet të kemi një besim më të madh të shtuar te biznesi, si njerëz që janë të vetëdijshëm për rregullat e shoqërisë, sepse në këtë kontekst, në këtë frymë mënyra si është paraqitur këtu tregon që janë parë si një kategori njerëzish që prodhojnë para dhe duhet t'i kufizojmë se na prishin funksionalitetin e shtetit. Unë nuk jam dakord me këtë frymë dhe do të isha për kuotën e 10 mijë lekëve të rinj, madje edhe kjo më duket shumë, por kjo të ishte e pranueshme. Ne duhet ta konsiderojmë biznesin si një harmonizim ligji midis interesave të shtetit, që është rregullatori, dhe biznesit, interesave të biznesit. Shteti nuk është ai që i thotë stop biznesit, por edhe e ndihmon. Këto gjoba janë kundër kësaj fryme, sipas meje.

Së dyti, sa i përket afatit, mendoj që duhet të ketë një afat jo 30-ditor, por 60-ditor, sepse ligji nuk është një rregull urgjencash. Nuk jemi në ushtri këtu të bëjmë ligje ushtarake ose në këtë datë ose nuk ka. Biznesi ka emocionet e ditës së punës së vet, ka problemet e ditës dhe ne nuk duhet ta pengojmë në rutinën e maksimalizimit të fitimeve të tij. Qëllimi i biznesit është të fitojë,

nuk është qëllimi i tij të kujdeset çdo ditë për ligjshmërinë. Unë them që e ngarkojmë më tepër memorien e tij, i shtojmë atij ankthin për të ekzistuar në treg, e bëjmë pesimist dhe jo optimist.

Gjithashtu, unë mendoj se klima miqësore duhet të jetë ajo që duhet të mbizotërojë në frymën e ligjit, dhe jo një klimë e distancuar, me një lloj hendeku, e përçmuar ose e marrë me indiferentizëm biznesin. Pra, ne nuk duhet të jemi shpërfillës ndaj interesave të biznesit. Është biznesi promotori i ekonomisë shqiptare ajo që na motivon ne të japim mendime sot, që motivon shoqërinë shqiptare.

Arben Ahmetaj –Faleminderit, zoti Roshi!

Ju iu referuat ikjes së bizneseve, por statistikat janë kokëfortë, pavarësisht emocioneve politike që ju sillni nga portalet ose ajo që thotë Basha përditë. Mbështetur në të dhënat e INSTAT-it do të kishim bërë një garë në medie.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, mos më ndërhyuni, sepse nuk ju ndërhyra!

Unë të nxjerr të dhënat nga INSTAT-i dhe QKB-ja, por i bie që të djegësh mandatin, ose unë mandatin tim, nëse ti ke të drejtë.

Janë mbi 14 mijë biznese të reja neto në vitin 2018 dhe çdo muaj ka regjistrime të reja neto, madje ka edhe rritje ekonomike. Zoti Roshi, unë e kuptoj se doni ta mbron me dinjitet partinë e ikur nga parlamenti dhe ju respektoj për këtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për partinë tuaj fola unë, nuk fola për atë që ka ikur. Ky është një sugjerim miqësor, profesional dhe kolegësh, nëse mund të jemi. Ju lutem, referojuni statistikës, sepse, kur bëni politikë pa statistikë, është shumë emocionale, e gabuar dhe nuk na marrin seriozisht. Pra 4,1% është rritja ekonomike, pastaj do të duhet të djegim mandatet në referencë të INSTAT-it. Po të bëjmë një garë, bazuar në të dhënat e INSTAT-it, ose djeg unë mandatin, ose djeg ti mandatin, por lista e Durrësit mbaroi dhe nuk keni më.

Kur të vijë neni përkatës, do të mund të shprehemi.

Ju lutem, në komision nuk flitet pa leje. Nuk kemi asgjë cinike këtu, jemi në raport me qytetarët dhe institucionet. Cinizmin unë nuk e kam stil, mund ta kisha nëpër korridore ndonjëherë, por këtu kurrë.

A ka ndonjë qëndrim tjetër në lidhje me projektligjin?

Zonja Mesi.

Senida Mesi – Faleminderit!

Në fakt, në lidhje me këto tri nisma ligjore, që shkojnë për shtat me gjithë rekomandimet e raportit të Manival, unë mendoj se rrugëtimi i Shqipërisë drejt integritetit dhe drejt Bashkimit

Europian është i qartë. Çdo nismë që vjen në plotësim të çdo detyrimi ose rekomandimi të Shqipërisë në lidhje me përmbushjen e detyrimeve, në rastin konkret të raportit për parandalimin e pastrimit të parave dhe rekomandimeve të Manival-it sigurisht që do të gjejnë mbështetjen e plotë në këtë komision dhe timin personal.

Unë kam disa gjëra që doja t'i komentoja sot, por, kur t'i kalojmë nen për nen, do të kem edhe dy propozime konkrete në lidhje me ndryshimin e nenit.

Vërej që ligji aktual parashikon, sikurse tha edhe kryetari, 30 ditë kalendarike për të deklaruar adresën, selinë ose adresat sekondare. Kjo vjen në të njëjtën linjë dhe shtohet këtu edhe pjesa e ndryshimeve në strukturën e pronësisë, por unë do të shtoja këtu edhe pjesën e çdo ndryshimi tjetër juridik jo vetëm të pronësisë, por edhe të administrimit. Unë kam një jetë të tërë që kam punuar me bizneset dhe mendoj se bizneset duhet të ndërgjegjësohen që çdo ndryshim juridik dhe ligjor që i bëjnë kompanisë së tyre duhet ta deklarojnë atë menjëherë. Kështu që afati 30-ditor është i mjaftueshëm.

Në kuadër të deregulimit nuk e di nëse është parashikuar që një deklaram i tillë mund të bëhet edhe *online* nëpërmjet e-albania-s, ku të aplodohet vendimi i aksionerëve me rekomandimet ose personin përkatës, i cili është i autorizuar për ta bërë një gjë të tillë. Nuk ka asnjë pengesë për asnjë institucion dhe asnjë biznes për të deklaruar brenda 24 orësh që ndodh ndryshimi. QKB-ja dhe të gjitha institucionet që punojnë me biznesin, duke përfshirë këtu edhe pjesën e tatim-taksave, duhet të bëjnë një punë ndërgjegjëse dhe njoftuese në web-in ose platformat e tjera të kompanive, që për çdo ndryshim që ato pësojnë në statusin ligjor, të njoftojnë në kohë.

Dua të adresoj dhe komentoj një lehtësim, i cili nuk u përmend në lidhje me ndryshimin e pikës 3 të nenit 26. Ligji dhe propozimi për ndryshim lehtëson biznesin. Nëse më përpara në nenin aktual duhej të paraqiteshin fizikisht për aplikimin e regjistrimit fillestar veç “themeluesit”, është shtuar edhe “administratori”, që sigurisht ka një tagër ligjor. Në aplikimin për regjistrim të veprimeve juridike ka qenë vetëm “anëtarët ortakë ose aksionerë” është shtuar “ose çdo person tjetër i autorizuar prej tyre” duke i krijuar kështu lehtësi pronarit, ortakut, aksionerit që me vendimin e asamblesë të autorizojnë një person tjetër në mungesë ose pamundësi për të bërë ndryshimet ligjore për të depozituar pranë QKB-së ndryshimet.

Në lidhje me rritjen e masës së gjobës nga 15 mijë lekë të rinj në 100 mijë lekë të rinj, pra pothuajse një 8-fishim, do të isha për një reduktim të kësaj gjobe, megjithatë kjo është një çështje që do të diskutohet në nenin përkatës.

Arben Ahmetaj - Para se të kalojmë në votimin në parim dhe nen për nen, kam një pyetje për të gjithë komisionin jo vetëm për ministrinë: A keni menduar për shoqëritë publike, që janë në tregun e aksioneve që mund të kenë jo më 1 ose 10, por 100-200-500 bashkëpronarë?

Besoj se ka një praktikë. Iu referua zotëria *acquis communautaire*, por nuk është besoj vetëm për *acquis communautaire*, por është për të gjithë praktikën e komisionit.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është pro? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1: “Pas pikës 4 të nenit 22, shtohet pika 4/1 si më poshtë vijon: Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë së personit juridik bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë me përjashtim të rasteve të parashikuara në ligj”.

A ka ndonjë pyetje ose mendim?

Po, zonja Senida.

Senida Mesi – Unë do të propozoja që këtu të shtonim edhe fjalët “dhe/ose strukturës së administrimit”. Pra, “Aplikimi për ndryshimin e ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik dhe administratorit dhe/ose strukturës së administrimit”.

Arben Ahmetaj – Pra të shtojmë fjalët “dhe/ose strukturës së ortakërisë të personit juridik dhe administratorit dhe/ose strukturës së administrimit”?

Senida Mesi – Po.

Arben Ahmetaj – Domethënë, ia delegon edhe poshtë administratorit.

Senida Mesi- Duhet të deklarohen edhe ndryshimet e administratorit brenda periudhës 30-ditore.

Arben Ahmetaj- A ka ndonjë mendim përfaqësuesi i ministrisë në lidhje me këtë?

Flogers Broqi- Në nenin 43 të ligjit aktual, në pikën 1, përfshihet që çdo ndryshim tjetër i detyrueshëm mbart edhe detyrimin për t’u regjistruar në regjistrin tregtar dhe një nga këto është edhe regjistrimi i administratorit të shoqërisë.

Arben Ahmetaj – Është e mjaftueshme, sepse neni që iu referua është parë dy herë dhe riparë me këtë logjikë për të forcuar detyrimin.

Unë kam një pyetje për t’u sqaruar vetë: Në afatin kohor prej 30 ditësh kalendarike nga data e ngjarjes së rrethanës faktike, kujt i referoheni konkretisht?

Flogers Broqi – Sa i përket ndryshimit të pronarëve ose aksionerëve edhe në bazë të Kodit të Procedurës Civile, subjektet mund ta ndryshojnë pronësinë edhe nëpërmjet aktit të shitblerjes.

Arben Ahmetaj- Kjo është rrethanë faktike apo është rrethanë juridike?

Flogers Broqi- Kjo është rrethana faktike, pra merret data kur është ndryshuar në kontratë.

Arben Ahmetaj – Dakord.

Artur Roshi- Afati kalendarik i 30 ditëve propozoj të bëhet 60 ditë.

Flogers Broqi - Ne mendojmë se 30 ditë është i mjaftueshëm.

Arben Ahmetaj - Kush është pro nenit, sipas propozimit të ministrisë? Kundër? Abstenime?

Miratohet.

Kalojmë te neni 2: “Pika 3 e nenit 26 ndryshohet me përmbajtjen si më poshtë vijon: “Aplikimi për regjistrimin fillestar të shoqërive tregtare bëhet bashkërisht nga të gjithë themeluesit ose nga administratori i shoqërisë ose nga çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrime të tjera bëhet nga personat përgjegjës për përfaqësimin e shoqërisë në marrëdhënie me të tretët ose çdo person i autorizuar prej tyre. Aplikimi për regjistrimin e veprimeve juridike me të cilat lidhet pjesëmarrja, kuotat ose aksionet mund të kryhet, gjithashtu, nga anëtari, ortakut ose aksioneri, të cilit ata i përkasin ose nga çdo person i autorizuar prej tyre”.

A ka ndonjë koment për këtë?

Evis Kushi- Në fakt, çelja ose regjistrimi fillestar i një biznesi vetëm nga administratori i shoqërisë, kur kemi një administrator shqiptar dhe të gjithë ortakët e huaj, më bën skeptike, lë vend për mundësi abuzimesh. Unë jam me idenë që këtu personi i autorizuar prej tyre pak a shumë edhe administratori mund të ishte një person i autorizuar nga ortakët. Pra, në momentin që ne themi “ortakët ose/dhe çdo person i deleguar prej tyre” edhe administratori mund të jetë pjesë e atyre personave, pse duhet thjesht autoriteti i vetëm i administratorit për të regjistruar një shpk të tërë?

Arben Ahmetaj- Mendoj se keni të drejtë, sepse administratorit i delegohet me ligj një e drejtë, të cilën e ka ortakut, dhe vetëm nëse ortakut ia delegon administratorit, atëherë administratori përfaqëson kompaninë, por jo automatikisht. Kjo është e regjistruar në ligjin e shoqërive tregtare, por këtu cenohet. Pra, propozimi ynë është: “ose nga administratori i shoqërisë kur autorizohet, jo automatikisht ose nga çdo person tjetër i autorizuar prej tyre”.

Senida Mesi- Unë jam me propozimin: “nga çdo person i autorizuar, përfshirë dhe administratorin”, që të jemi dakord edhe me gjuhën juridike.

Arben Ahmetaj- Gjuhën teknike e rregullojmë me sekretarinë, ideja është që administratori të mos ketë një të drejtë të pakufizuar.

Flogers Broqi- Ligjërisht administratori merr çdo tagër për të përfaqësuar shoqërinë me palët e treta që nga momenti i nënshkrimit të statutit të themelimit.

Arben Ahmetaj- Po pse e keni sjellë këtu një nen të përsëritur, që të kalojë legjislativi kohë me klauzola të përsëritura pa fund?

Flogers Broqi- Ky nen nuk e përfshinte të drejtën e administratorit. Në nenin 26 nuk ishte deri sot e përfshirë.

Arben Ahmetaj– Po, është në ligjin e shoqërive tregtare.

Flogers Broqi- Po, ky ishte ligj procedural, në ligjin e shoqërive tregtare administratori përfaqëson kompaninë me palët e treta. Ndërsa këtu është ligji procedural

Arben Ahmetaj – Kjo do të thotë që ortaku duhet ta autorizojë.

Flogers Broqi - Është i mjaftueshëm, zoti kryetar, vetëm miratimi i statutit të ushtarakut. Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Atëherë të shtohet fjala “i autorizuar”.

Kalojmë në votimin e nenit. Kush është pro me sugjerimin që bëri komisioni? Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 2.

Neni 3.

Të prish punë, aq sa ç’të prish punë përsëritja, që do të thotë se nuk të prish punë, ndërsa në eksperiencën time shumë modeste, në krahasim me tuajën, në terrenin ekonomik dhe fiskal dhe të *AntiMoneyLaundering* mund të krijojë problematika. Ka pasur raste në QKB-të, që nuk merren vesh akoma, janë nëpër gjyqe, sepse administratori ka shkuar ka ndryshuar ortakërinë.

Unë do të propozoj në një moment të caktuar që njësia e *AntiMoneyLondering* kundër pastrimit të parave, se vërtetë thotë zoti Roshi 60 ditë, vërtet do të themi ne se do të ulet gjoba, por, nëse kjo nuk ndodh, atëherë menjëherë kthehet në objekt të investigimit nga njësia. Ky është kusht. Pra, praktika në terrenin ekonomik është që, në qoftë se ortakëria e neglizhon këtë, atëherë i lind e drejta njësisë. Kuptohet pastaj, njësia ka ligjin e vetë të procedimit dhe administrimit që ta kthejë në objekt të investigimit për procedurat e veta kundër pastrimit të parave, se në qoftë se dikush nga ortakët nuk e bën për 30 ditë apo 60 ditë, nuk ka rëndësi për 1 milion apo 2 milionë lekë të vjetër, o ka një neglizhencë serioze, që nuk duhet ta ketë, o ka një arsye përtej, që duhet investiguar.

Faleminderit!

Pas pikës 3 të nenit 74 shtohen pikat 3/1 dhe 3/2 si më poshtë vijon: 3/1. “Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut ose strukturës së ortakërisë së personit juridik brenda 30 ditëve kalendarike, nga data e ngjarjes së rrethanës faktike të ndryshimit të ortakut dhe/ose strukturës së ortakërisë, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë 100 mijë lekë”.

Unë kam një pyetje thjesht për t'u iluminuar: “Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga ligji”. Çfarë do të thotë kjo?

Flogers Broqi - Faleminderit, zoti kryetar!

Përjashtimi i rasteve është për shoqëritë aksionere, të cilat nuk detyrohen ta sjellin çdo 30 ditë pasi të mbarojë vendimi, sepse vet ligji për regjistrimin e biznesit dhe ligji për shoqërinë tregtare e detyron administratorin e shoqërisë aksionere të mbajë një regjistër të veçantë të aksionerëve dhe këta kanë detyrimin ta dorëzojnë listën e përditësuar të aksionerëve me depozitimin e bilancave financiare vetëm një herë në vit pranë Regjistrat Tregtar.

Ky është rasti përjashtimor.

Arben Ahmetaj – Praktikisht, ne po bëjmë një ndryshim vetëm për personat fizikë dhe biznesin e vogël. Pra, sh.a-të kanë detyrim në një ligj tjetër dhe me këtë ligj i përjashtojmë, ndërsa sh.p.k-të dhe personat fizikë i detyrojmë.

Thjesht e bëra këtë sqarim për të qartësuar komisionin që po shtojmë një procedurë për sh.p.k-të, që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do të të vijë radha. Duhet t'i kërkoj leje ministres që të flasësh, se ai që ishte këtu para meje, nuk më linte. Një punonjës administrate e pyeste: “More leje nga ministri?” - pastaj e lejonte.

Dua të jemi të qartë se çfarë jemi duke bërë. Nuk pyeta më kot se çfarë përjashton ligji. Togfjalëshi është shumë i rëndësishëm. Pra, kushti juridik për sh.a-të është një ligj tjetër me frekuencë shumë më të madhe se sa kërkohet këtu. Pra, vetëm një herë në vit, kur dorëzojmë bilancet.

Floger Broqi - Faleminderit!

Ndryshimet prekin edhe shoqëritë aksionere, pa diskutim, sepse pika 3/2 që është shtuar në nenin 74, pikërisht për këtë arsye ka bërë ndarjen, meqë nuk është afati 30 – ditor dhe nuk kanë detyrimin, që çdo ndryshim që u përket aksionerëve të depozitohet 30 ditë në regjistrin tregtar, u është lënë afati 12 - mujor. Ndaj është ndarë në dy logjika: ndëshkimi ose masat administrative.

Arben Ahmetaj – Kam një pyetje tjetër, Flogers, cilat raste përjashtohen nga 30-ditëshi?

Floger Broqi - Zoti kryetar, nga 30-ditëshi përjashtohen vetëm shoqëritë aksionere. Sh.p.k-të kanë detyrimin që brenda 30-ditëshit të bëjnë regjistrimin. Pra, me përjashtim kur ligji thotë ndryshe, pikërisht për shoqëritë aksionere, nuk e kanë 30 ditë, por e kanë një herë në vit detyrimin që ta sjellin me bilancet financiare ndryshimin e aksionerëve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, detyrimin për të dorëzuar listën e aksionerëve dhe të ortakëve në Regjistrin Tregtar e kanë të gjitha llojet e shoqërive. I vetmi është ndryshimi kohor kur ligji ka parashikuar ndryshe.

Shoqëritë tregtare sh.p.k.-të duhet ta dorëzojnë brenda 30 ditëve nga marrja...

(Mungesë audio)

Arben Ahmetaj – Po, ju lutem.

Evis Kushi – Për qëllime të teknikës legislative, pikat 3/1 dhe 3/2 ndryshojnë duke mos e përsëritur edhe një herë atë detyrimin, i cili është përcaktuar në nenin 22 të pikës 4. Pra, nuk është nevoja që paragrafi të jetë kaq i gjatë, të mos themi: “Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakut...” e të tjerë, por të themi: “Mosrespektimi i detyrimit të përcaktuar në pikën 4, të nenit 22, përbën kundërvajtje...” e kështu me radhë.

Kjo vlen për të dyja pikat, 3/1 dhe 3/2.

Arben Ahmetaj – Mund të ishte edhe kështu, por gjithsesi gjykimin do t’ia lëmë ministrisë. Si mendoni?

Evis Kushi – Neni e ka përcaktuar që detyrohen të kryejnë këtë regjistrim. Ti këtu thua: “Po nuk e respektove këtë nen...”...

Arben Ahmetaj – Je shumë e qartë!

Është sugjerim shumë normal, por më takon të pyes edhe ministrinë, në qoftë se kanë ndonjë merak pse e kanë ndarë.

Në këndvështrimin tim, nuk ka asnjë merak, mund të bashkohen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po. Mund të bashkohen? Në rregull, atëherë.

Ka ndonjë koment tjetër?

Po, Senida.

Senida Mesi – Marr në konsideratë pikërisht ndarjen, ku pika 3/1 u referohet kryesisht sh.p.k.-ve dhe pika 3/2 vetëm shoqërive aksionere, duke pasur parasysh që në pikën 3/1 shoqëritë sh.p.k. kanë afat 30-ditor për të regjistruar ndryshimet në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe shoqëritë aksionere 12 muaj, duke marrë në konsideratë edhe xhiron, edhe të ardhurat e secilës kompani. Unë do të propozoja 50 mijë lekë gjobë në rastin e parë dhe 100 mijë lekë gjobë, sikurse është propozuar edhe nga ju, për rastin e dytë, duke pasur parasysh që janë 12 muaj, kohë e mjaftueshme, sikurse e parashikon edhe ligji për dorëzimin e pasqyrave financiare dhe, nëse nuk e deklarojnë aty, është mjaftueshëm kohë, ose le të themi, kundërvajtje administrative e qëllimshme dhe të rritet niveli i gjobës. Kurse për sh.p.k.-të, falë edhe afatit në dispozicion edhe të diferencimit në gjobë prej 50 mijë lekësh...

Arben Ahmetaj – Anëtarë të komisionit, kam nevojë për vëmendjen tuaj!

Zonja Mesi sapo bëri propozimin për uljen e gjobës për sh.p.k.-të, pra një diferencim midis penalizimit të mosdeklarimit brenda 30 ditëve për sh.p.k.-të dhe penalizim për sh.a.-të për mosdeklarim, 50 mijë lekë për sh.p.k.-të dhe 100 mijë lekë për sh.a.-të.

Ka ndonjë mendim?

Zoti Roshi, fjala për ju.

Artur Roshi – Unë mendoj që për sh.p.k.-të gjoba të jetë në kuotën e 10 mijë lekëve të rinj, ndërsa për sh.a.-të të jetë 20 mijë lekë të rinj.

Duhet të ndryshojmë konceptin. Vendosja e gjobave ndaj biznesit nuk përbën sens dhe nuk e bën atë më të mirë, por thjesht i shton ankthin dhe frikën për të vazhduar. Unë nuk e kuptoj mendësinë e ministrisë që kërkon ta frenojë atë.

Ky është propozimi im.

Arben Ahmetaj – Unë do të bëj një koment në lidhje me këtë nen. Mos harroni se, pavarësisht se këtu nuk është shënuar dhe ministria nuk e theksoi, do të bëhet Regjistri i Ortakërisë. Është një regjistër shumë i rëndësishëm, jo thjesht për gjithë procedimin apo preventivimin e pastrimit të parave, por nesër e tutje do të kalojmë edhe në shkallë të tjera të tregut dhe transaksioneve në treg dhe regjistri do të jetë themeltar për këto.

Pra, nuk është se po bëjmë një procedurë fiskale apo një procedurë të *AntiMoneyLondering*, por do të duhet që ne, si deputetë, ta mendojmë se jemi duke bërë një shkallë, një hap para drejt...

Nesër e në vazhdim do të kemi tregun e aksioneve; do të kemi, nuk e dimë çfarë logjike do të na sjellë qeveria, jam i bindur që po e mendojnë.

Regjistri i Aksioneve është i rëndësishëm, që do të përdoret tashmë jo vetëm nga njësia, ajo do ta ketë një herë në kaq apo aq, ministria e ka sjellë për çek, ne do ta shohim si një hap më larg. Kështu që mos e shikoni gjobën si një konsekuencë e domosdoshme për të mbledhur para nga biznesi, jo, ta shohim atë si një shtysë për të arritur te Regjistri i Aksionerëve, që është instrument shumë i rëndësishëm.

Gjithsesi, keni të drejtën të bëni propozimet tuaja.

Ka ndonjë qëndrim tjetër, zonja ministre?

Anila Denaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Kundërvajtja administrative, e cila dënohet me gjobë është për moskryerjen e detyrimit të regjistrimit, e ndryshimit të ortakërisë dhe në këtë pikë, afati nuk është element për të përshkallëzuar gjobën, sepse moskryerja e detyrimit të regjistrimit, si në rastin e sh.k.p.-së...

Arben Ahmetaj – Po t’i kthehemi propozimit të zonjës Senida, ajo nuk përdori afatin për të përshkallëzuar gjobën, përdori xhiron dhe fitimin, pra peshën e kompanive. Kjo ishte, zonja Senida?

Megjithatë, unë e mendoj afatin shumë normal.

Për sa i përket masës së gjobës, ka ndonjë mendim për propozimin e zonjës Senida dhe pastaj t’i hedhim të dyja propozimet në votim, edhe atë të zotit Roshi?

Edlira Hyseni - Do të mbështesja propozimin përpara. Do të isha për masën e gjobës për sh.p.k.-të 30 mijë lekë të rinj, dhe 50 mijë për sh.a.-të.

Ju faleminderit!

Anastas Angjeli - Me çfarë po kuptoj, po sorollatemi kot 1 orë e ca për pjesën e gjobave. A mund të na thoni dy gjëra: mbi ç’kriterë i keni vendosur ato gjoba në raport me gjobat e tjera, meqë janë rritur, siç thuhet këtu, 5 apo 7 herë, pse 5 dhe jo 3? Pse 7 dhe jo 2?

Kaq na thoni dhe t’i japim fund kësaj pune.

Arben Ahmetaj – Cili është qëndrimi i ministrisë lidhur me propozimet, në mënyrë që t’i votojmë pastaj?

Anastas Angjeli - Këtu secili do të thotë nga një gjobë.

Arben Ahmetaj – Po, edhe të drejtë kanë të thonë!

Anastas Angjeli - Të drejtë kanë, por nuk bëhet kështu!

Së pari, na thoni kriteret, dhe e dyta, nga se jeni nisur që e keni bërë 7 herë më të madhe dhe jo 3 herë? Vetëm pse ai tjetri është ligj i vitit 2009? Korrigjoni atë ligj, atëherë!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, ministrja.

Anila Denaj – Ne i qëndrojmë propozimit të njëjtë dhe, sikurse u tha edhe në fillim, do ta rishqyrtojmë ligjin e vitit 2009, pasi gjobat janë jo proporcionale dhe ky gjykim është i drejtë, por kemi nxjerrë vetëm këtë nen brenda paketës Manival dhe paralelisht do të fillojmë punën për rishikimin e të gjithë ligjit që të bëhet referenca.

Arben Ahmetaj – Dakord, por shënojeni në regjistër edhe ju, ta shënojmë edhe ne, që, kur të vini me atë ligj, në qoftë se gjobat tuaja janë rritur, i bie që keni vendosur një standard këtu. Pra, keni vendosur një standard që do të rrisni gjobat 8 herë, por mos harroni se kur të vini këtu, do t’i kthehemi këtij ligji prapë për të ulur gjobën.

Kështu që sugjeroj të bëjmë një reflektim se, kur të vini me ligjin e vitit 2009, me gjobat 7 herë, mos mendoni se ky komision do të kalojë gjobat 7 herë të rritura. Besoj se është moment reflektimi dhe, në qoftë se keni ndonjë sugjerim të ri, na e thoni, në qoftë se jo, t’u referohemi sugjerimeve të komisionit.

Anila Denaj – Jam e mendimit, zoti kryetar, që gjoba nuk duhet të jetë qëllim në vetvete as për biznesin dhe as për ministrinë dhe ky nuk duhet të jetë kërcënim. Në qoftë se regjistrimi ndodh brenda afateve të gjykuara të arsyeshme, çdo ortak dhe çdo ndryshim regjistrohet, kjo duhet të prevalojë. Ndaj, nuk duhet të na trembë një gjobë edhe 8-fish e shtuar.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Ministria ka të drejtë të mbajë qëndrimin e vetë! Ajo është përfaqësuese e qeverisë, ju lutem, të mos komentojmë se çfarë thotë ministrja. Ky është vendim i qeverisë dhe detyra jonë është ta mbështesim; nëse nuk biem dakord, të bëjmë sugjerime dhe të biem dakord me ministrinë. Kjo nuk është tryezë që mund të bëjmë thashetheme jashtë mikrofonit.

Zonja Ministre, unë e theksova që në momentin e parë, që në rastin konkret, do t'u referohemi dy arsyeve shumë të rëndësishme, dhe unë besoj që duhet ta theksojmë disa herë atë.

Së pari, cila është arsyeja që e kërkojmë këtë, duhet ta themi këtu? Besoj se ai do të duhej të ishte edhe fillimi i qëndrimeve tona.

Kemi dy pse e kërkojmë ortakërinë të detajuar: një të drejtpërdrejtë dhe një të pathënë nga ju, por që duhet nënkuptuar nga çdo lloj deputeti apo qytetari që na dëgjon.

E para, risku i pastrimit të parave ekziston kur ortakët me qëllim ose me neglizhencë, ose për 1 mijë arsye, nuk janë të deklaruar, deklarohen me vonesë e të tjera, dhe, për shkak të mbajtjes së aksioneve duhet të jenë objekte dhe subjekte të pastërtisë në aspektin e pastrimit të parave apo të preventivimit të pastrimit të parave. Që këta të bëhen objekte/subjekte do të duhet të jenë të regjistruar, do të duhet të dihet në kohë reale se cilët janë. Kjo është arsyeja. Nuk jemi duke kërkuar ndonjë çudi, kjo është praktikë ndërkombëtare dhe është normale, dhe sikur të mos ishte ndërkombëtare do të duhej ta kërkonim ne. Kjo është logjika normale që duhet bërë.

E dyta, regjistri i ortakërisë është instrument shumë i domosdoshëm në nivelet që do të duhet të kalojë tregu nesër për sa u përket transaksioneve të mundshme. Kjo është e sigurt, në mos do të vijë për 1 vit, do të vijë në vitet pasuese dhe ne duhet të fillojmë punën, pavarësisht se ligji nuk i referohet tani. Një nga konsekuencat e ligjit është automatikisht ajo gjë, por unë e theksoj përsëri, zoti Koçi, se njësia, në qoftë se, për shembull, unë nuk e deklaroj ortakërinë, kushdo qoftë në Republikën e Shqipërisë, nuk besoj se është gjoba ajo që i rri si çekiç.

Po marr një ushtrim, që do të duhet ta marrësh edhe ti në njësinë tënde: dikush, një ortak, i cili e bën me qëllim mosdeklarimin, as do t'ia dijë fare për këtë gjobë. Çfarë ndodh? Sigurisht, në procedurën tënde, në momentin që ai nuk e deklaroi brenda tridhjetë ditëve, automatikisht kthehet në objekt/subjekt hetimi. Pra, ai është kërcënim, jo gjoba.

Kjo është e sigurt.

Megjithatë, unë mendoj të reflektojme një sekondë me votë për propozimin e zonjës Senida. Kush është pro uljes së masës së gjobës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, propozimi i zonjës Mesi është, dhe le t'i referohemi nenit 3, sepse jemi nen për nen: “Moskryerja e detyrimit për regjistrimin e ndryshimit të ortakërisë”, që është pika 1 e nenit 3 “dënohet me gjobë 50 mijë lekë”, - thotë zonja Mesi, pra gjysma e asaj që ka sjellë qeveria.

Në bazë të propozimit tuaj për të bashkuar paragrafët, pra nuk do të ketë një pikë 2 të nenit 3...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po pra, por nuk ishte ai qëllimi. Ama, gjoba mbetet 100 mijë lekë në rastin e dytë. E thashë në mënyrë korrekte, zonja Mesi, propozimin tuaj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro propozimit të zonjës Mesi?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në qoftë se u pranua njëri, i bie që të tjerët të bien automatikisht.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, po i votojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull. Kush është pro propozimit të zonjës Mesi? Unë do të votoj i fundit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mbani qëndrim me votë, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Angjeli.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për uljen e masës së gjobës, nga 100...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, se po kaloi ky, mbaron.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjitha.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kundër? Abstenim?

Miratohet propozimi i zonjës Mesi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka nevojë ta merrni fjalën për procedurë, sepse kaluam propozimin e zonjës Mesi.

Fatkeqësisht dhe fatmirësisht dy propozimet e tjera bien.

Atëherë, votojmë edhe nenin 3, me ndryshimet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo 3/2-shi!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Kushi, fokus! Pra, 3/2-shi është 100 mijë lekë, por, për teknikë legislative, do t'i referohem me ndryshimet që propozuat ju.

Biem dakord me nenin 3, me ndryshimet?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, kemi edhe nenin 4 “Hyrja në fuqi”: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

E hedhim në votim në tërësi projektligjin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet edhe në tërësi projektligji.

Faleminderit!

**Sekretar
Anastas Angjeli**

**Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

**Sekretar i komisionit
Elvi Prifti**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni Parlamentar për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë më, 05.06.2019, ora 10.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Artur Roshi dhe Krenar Ryci.

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Anila Denaj – Ministre e Ekonomisë dhe Financave

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Elvis Koçi –

Niko Lera –

Agron Muslia –

Flogers Broqi –

Mikeljan Shkalla –

Arben Ahmetaj – Vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës: shqyrtimi i projektligjit “Për disa shtesa në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar””.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t’i lutesha komisionit, meqenëse me ligjin e parë u vonuam, në kuptimin që u thelluam në shqyrtim, dy projektligjet e tjera janë disi më të thjeshta, të mos zgjatemi, sepse parimet janë diskutuar. Kështu që besoj se në trajtimin e dy projektligjeve të tjera do të kemi vetëm teknikë legjislativë.

Kush është relatorja?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Dhima, vazhdojmë.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji që po diskutojmë, ka si qëllim adresimin e njërit prej rekomandimeve të Komitetit të Ekspertëve të Këshillit të Europës për vlerësimin e masave kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit lidhur me përdorimin e parasë fizike dhe reduktimin e ekonomisë informale nga personat fizikë dhe juridikë tregtarë.

Nëpërmjet këtij projektligji propozohet vendosja e detyrimit për të gjithë tatimpaguesit, që janë persona fizikë; subjektet e regjistrimit me TVSH; tatimpaguesit, që janë persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi i realizuar, si dhe organizatat jofitimprurëse, të regjistruara sipas legjislacionit në fuqi për hapjen, pasjen e llogarive bankare dhe deklarimin e tyre në organet tatimore.

Nga ky detyrim janë përjashtuar vetëm tatimpaguesit, persona fizikë, që nuk janë subjekt i detyrimit për t’u regjistruar për TVSH-në, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor më të vogël se 2 milionë lekë, bazuar në ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në aktet e tjera ligjore në zbatim të këtij ligji.

Projektligji përcakton, gjithashtu, edhe afatet konkrete për hapjen e këtyre llogarive bankare si për tatimpaguesit, që normalisht janë të regjistruar në regjistrin tregtar dhe pranë QKR-së, ashtu edhe për ata, të cilët do të regjistrohen rishtazi.

Gjithashtu, projektligji ka vendosur edhe sanksionet për tatimpaguesit, të cilët nuk do t’i përmbushin detyrimet për hapjen e llogarive bankare.

Prandaj, nisur nga këto argumente, i ftoj të gjithë kolegët deputetë që ta miratojmë këtë projektligj.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Dhima!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ministre, besoj se qëndrimi është i qartë, por kam një kërkesë për ju. Besoj se do të duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, Vullnet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është e rëndësishme, pasi ka të bëjë edhe me një shqetësim tuajin, që e keni shprehur përpara disa javësh. Do të duhet që të uleni me Guvernatorin dhe ta detyroni sistemin bankar me instrumentet ligjore që keni, që kostoja e hapjes dhe e mbajtjes së llogarive të ulet, sepse tani do të kemi të gjithë mbi 2 milionë lekë xhiro dhe do t'i kemi me detyrim në sistemin bankar. Nëse jo, do të gjobiten, por në momentin që do të jenë në sistemin bankar, nuk duam të shtojmë kostot për biznesin e vogël.

Mbajtja e llogarive...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo është kërkesa ime personale, por edhe e komisionit, me një urgjencë në bazë të instrumenteve që jua lejon ligji, ku bashkë me Guvernatorin të ulni kostot e mbajtjes së llogarive. Pjesa tjetër është perfekte për mua, madje nuk ka nevojë fare ta diskutojmë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që secili nga ju do të mbajë qëndrime, sado edhe ju e keni për pozicionim politik njohjen me qytetarët, me votuesit tuaj, që kanë votuar listën e parë, por që në parlament është lista e dytë, në bazë të ligjit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Edlira Hyseni – Tani, së pari, nuk e di nëse ka rëndësi lista e parë ose e dyta, pasi besoj që në këtë komision jemi të gjithë përfaqësues të njerëzve që na dëgjojnë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju i shihni shumë normale dhe të thjeshta ndryshimet e ardhura, por për praktikën e biznesit që njohim, nuk besoj se ky ndryshim do të mirëpritet nga biznesi i vogël me kaq dëshirë dhe lehtësi, pasi biznesi i vogël ka problematikat dhe vështirësitë e tij.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di biznesi i Tiranës, por, të paktën, nga periferia prej nga vijmë ne, nuk janë kaq të përparuar dhe mikpritës ndaj ndryshimeve të tilla.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Tani, ajo që më tërheq vëmendjen...

(Diskutime në sallë)

Arben Ahmetaj – Ju lutem, zonja Senida, në respekt të deputetes së opozitës, për qëndrimin që po mban pro biznesit!

Edlira Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Më tërhoqi vëmendjen detyrimi që personat fizikë, flasim kryesisht për biznesin e vogël, duhet ta hapin patjetër llogarinë bankare dhe ta deklarojnë tek organi tatimor. Por, në dijeninë time, as bizneset e mëdha nuk e bëjnë deklarimin e llogarive bankare tek organet tatimore, edhe pse diku mund të jetë dhe është detyrim ligjor. Pra, në pasqyrat financiare që dorëzojnë nuk japin domosdoshmërisht të dhëna për llogaritë bankare. Ndaj, shtroj pyetjet: pse është menduar që biznesi i vogël të detyrohet ta bëjë këtë deklaratë? Si do ta deklarojë në administratën tatimore llogarinë e biznesit?

Së dyti, ju thoni që, në rastin kur nuk disponojnë llogari bankare për transaksionet që kryejnë, do të dënohen. Tani duhet të kemi parasysh që një biznes i vogël me xhiro rreth 2 milionë ose më pak, ose pak më shumë se aq, jo domosdoshmërisht duhet ta ketë si detyrim. Poshtë 2 milionëshit përjashtohen, ndërsa mbi 2 milionëshin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Desha të thosha pak më lart.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pragu i 2-milionëshit lë gjithnjë vend për diskutim, por bizneset e vogla, me vendosjen e kasës, që i lejon të bëjnë transaksione deri në vlerën 150 mijë lekë të rinj, nëpërmjet kuponit tatimor dhe faturave tatimore përkatëse, dhe ka detyrime që paguajnë vetëm shtetin, sigurimet shoqërore, tatimin e qirasë dhe taksat e bashkisë, pak a shumë, në dijeninë time, me bankat nuk kanë marrëdhënie kaq të domosdoshme. Pra, nëse një biznes i vogël i kryen transaksionet nëpërmjet xhiros ditore të kasës ose veprimeve që lejon ligji dhe, detyrimet ndaj shtetit i paguan me derdhjet *kesh* në llogari, pse duhet të detyrohet të hapë llogari bankare nëse nuk e përdor?

Unë nuk e kuptoj nëse i gjithë pastrimi i parave ka ardhur nga biznesi i vogël, ndoshta këtej nga Tirana, se nga Durrësi nuk besoj se janë kaq të përparuar.

Gjithashtu, masat e gjobave në vlerën 50 mijë lekë, 100 mijë lekë, për biznesin e vogël, singërisht më duken shumë të larta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di nëse isha e qartë në fjalën time.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Këto pyetje kishit?

Edlira Hyseni – Tani për tani, po.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Nuk e di nëse jeni në dijeni, por, praktikisht, një biznes i vogël me 2 milionë mund të ketë blerje nga një biznes i madh, i cili shkon mbi 150 mijë lekë, që është niveli i kesh-it.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Por mund t'i ketë.

E dyta, detyrimi që ndodh këtu, është përputhur me interesin e fiskut për t'i njohur llogaritë, që është i domosdoshëm.

Të mos e detajojmë këtu, por në një të nesërme në sistemin e fiskalizimit do të jetë çdo gjë e lidhur, që nga dogana deri te banka, brenda biznesit të vogël dhe atij të madh, që nga marrëdhënia biznes – klient deri te biznes – biznes.

E treta, është detyrimi i preventivimit, që është kërkesë e MONEYVAL-it dhe nuk është e kotë. Pra, nuk është thjesht një kërkesë për të regjistruar procedurën; është domosdoshmëri.

Ne mund të diskutojmë sa të duam dhe të rrimë këtu me orë të tëra, por thelbi i gjësë është fare i thjeshtë: është e domosdoshme të kenë llogari bankare, aq më tepër që në një të nesërme qeveria me ligj mund t'i kërkojë Kuvendit të ndryshojë ligjin e procedurave, ku nga 1 milion e 500 mijë lekë të vjetër, ta çojë kesh-in në vlerën 500 mijë lekë të vjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo do të thotë që diskutimi ynë tani...

Do t'ju lutesha...

Unë e kuptoj edhe rëndësinë e të mbajturit qëndrim qoftë politik, qoftë teknik, por...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo me logjikë teknike procedurale të domosdoshme.

Sepse është e domosdoshme! Çfarë do të thotë? Hajde të lëmë një pjesë të bizneseve jashtë në kesh. Absolutisht! Ne po shkojmë drejt logjikës për të reduktuar keshin, për ta rritur formalizimin, pastaj të themi: jo, shiko, se mund t'i duhet të paguajë kesh. Paguaj kesh, por aq sa lejon ligji!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, ju iu referuat tjetër gjëje.

Për masën e gjobës do të flasim kur të vijmë nen për nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Artur Roshi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj se, ose duket qartë që hartuesit e këtij drafti kanë pasur një target-grup, i cili është i kufizuar në logjikën time. Pra, mund të jemi në kufijtë e 15-shit ose 2%-shit, sepse kemi parasysh që me pastrimin e parave ose me financimin e terrorizmit nuk mund të merren bizneset e vogla.

Unë them se rreziku këtu është i vogël, prandaj gjykoj që fryma e këtij drafti duhet të ndryshojë qoftë me gjobëvënien ndaj moshapjes së llogarive të tyre, pra kontrollit të të gjitha llogarive të biznesit, si person fizik, person juridik, pra nën dhe mbi shumën 8 milionë lekë të rinj. Pra, ne nuk mund të shmangim 99% të njerëzve, që bëjnë biznes në mënyrë të ndershme, ndërkohë që për ata, që dyshojmë se mund të financojnë terrorizmin, që mund të jetë 1%, ne të fokusohemi dhe të godasim edhe pjesën e 99%-shit. Kjo është logjika e kësaj që them unë.

Mendoj se duhet të jemi dakord në parim për hapjen e llogarive të të gjitha llojeve të bizneseve, por masa e gjobave është jashtëzakonisht e madhe. Për shembull, masa e gjobës për një biznes të vogël nuk mund të jetë 500 mijë lekë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do ta diskutojmë kur të vijmë nën për nën? Dakord, tërhiqem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, nga 500 mijë lekë, unë jam i mendimit që masa e gjobave të shkojë në kufijtë e 5 mijë lekëshit, sepse kaq është fuqia e...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk janë numra këta, zonja Ministre, por janë para që dalin nga djersa e shqiptarëve! Kështu që duhet të bëjmë kujdes kur vendosim zero pas numrave.

Unë them që ky 500-mijëshi të bëhet 5-mijë, ndërsa 100-mijëshi të bëhet 50-mijë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po për këto, që janë fitimprurëse, ku t'i gjejnë paratë për 75 mijë? Unë jam i mendimit që edhe këto të jenë në kufirin e 5-mijëshit, njësoj me bizneset e vogla, për të ruajtur logjikën tuaj për të mos i lënë pa gjë, por të vijmë në kufijtë normalë dhe funksionalë të tyre.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Më falni, por logjika e ndryshimeve ligjore ka të bëjë me një kërkesë të rëndësishme antiinformalitet, nuk është thjesht Moneyval-i që na e kërkon; këtë duhej ta kishim kërkuar ne.

Logjika e gjobës do të diskutohet në shqyrtimin nen për nen, pasi duhet parë me patjetër, ndërkohë që do të duhet të rakordojmë me ministrinë, sepse çdo transaksion, që është mbi nivelin e kërkuar nga ligji në kesh, ka penalitete të tjera të tij. Pra, do të duhet që t'i harmonizojmë penalitetet në lidhje me atë transaksion.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni kundër formalizimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E qartë, por, në fakt, duhet të jeni pro formalizimit të ekonomisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Abstenim?

Miratohet.

Vijmë me shqyrtimin nen për nen.

Neni 1. Në nenin 59, pas pikës 1/1, shtohet pika 1/2 me këtë përmbajtje: “Tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar; tatimpaguesit, persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit, organizatës së regjistruar, dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore”.

Ka ndonjëri sugjerime?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim?

Miratohet neni 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni, e tërheq për një sekondë, për shkak të qëndrimit që ka Shërbimi i Kuvendit. Në nenin 59, pas pikës 1/1 shtohen pikat 1/2 dhe 1/3, të dakordësuar me ministrinë, në dijeninë time, thjesht për shkak të teknikës legjislative.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, një paragraf i nenit 2 kalon te neni 1.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më konkretisht, në pikën 1/2 thuhet: “a) Tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar; b) Tatimpaguesit, persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi që realizojnë, si dhe organizatat jofitimprurëse të regjistruara në organin tatimor janë të detyruar të kenë llogari bankare të biznesit, organizatës së regjistruar, dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore”, ndërsa në pikën 1/3 thuhet: “Tatimpaguesit e regjistruar rishtazi janë të detyruar të hapin llogari bankare të biznesit, organizatës, jo më vonë se 20 ditë kalendarike nga e nesërmja e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e drejtpërdrejtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në rregull.

Për nenin 2, i cili trajton sanksionet, sugjerohet nga shërbimet e Kuvendit që të riformulohet. Do t'i lutesha ministrisë të na ndjekë, së pari, për shkak të kalimit të paragrafit 3 te neni 1 dhe, së dyti, për faktin se paragrafi 4, që është i fundit për këtë nen, gjithashtu, edhe pse nuk trajton sanksione, është një dispozitë transitore. Për këtë arsye sugjerohet që paragrafi 4 i nenit 2 të kalojë në një nen më vete, si dispozitë transitore, pra për ta mbajtur nenin të pastër.

Për sa më sipër, edhe për shkak të teknikës legjislative, sugjerohet riformulimi i nenit 2 me këtë përmbajtje...

Biem dakord me nenin 1, me ndryshimet që kemi sugjeruar si komision?

Kundër? Abstenim?

Miratohet neni 1, që kushtëzon edhe ndryshimet në pjesën tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Neni 2. Në nenin 120 shtohen paragrafët me këtë përmbajtje: “Subjektet e përmendura në pikën 1/2 të nenit 59 të ligjit, në rastin kur nuk disponojnë llogari bankare për transaksionet që kryejnë, dënohen si më poshtë vijon:

a) Tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar me qarkullim deri në 8 milionë lekë gjobë, **në masën 50 mijë lekë;**

b) Tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 milionë lekë, gjobë në masën 100 mijë lekë;

c) Organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 mijë lekë. Nëse subjekti nuk ka llogari bankare për transaksionet që kryen edhe pas dënimit si më sipër, dënohet me dyfishin e gjobës së parë. Subjektet e regjistruara rishtas ... Është ndryshimi që bëmë.

Subjektet që janë të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit/administratën tatimore duhet të hapin llogarinë bankare jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në fuqi e këtij

ligji dhe ta deklarojnë atë në administratën tatimore. Po lexoj qëndrimin e Shërbimit të Kuvendit dhe do t'u lutesha përfaqësuesve të ministrisë të fokusohen.

Në nenin 120 shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje: “Mospërmbushja e detyrimit të përcaktuar në pikën 1/2 dhe 1/3 të nenit 59, të këtij ligji nga tatimpaguesit dënohen, si më poshtë vijon:

a. Për tatimpaguesit, persona fizikë tregtarë, të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar, me qarkullim deri në 8 milionë lekë, gjobë në masën 50 000 lekë;

b. Për tatimpaguesit persona juridikë, pavarësisht nga qarkullimi, si dhe tatimpaguesit persona fizikë tregtarë, me qarkullim mbi 8 milionë lekë, gjobë në masën ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A mund të vijoj?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Është çështje procedurale. Unë nuk kërkoj të më lini ta mbaroj, por ju detyroj me procedurë që ta mbaroj.

“c. Për organizatat jofitimprurëse, gjobë në masën 75 000 lekë. Në rast të mosrespektimit të detyrimit sipas pikave 1, 2, dhe 1/3 të nenit 59 të këtij ligji dhe pas dënimit sipas shkronjave “a” dhe “b” dhe “c” të këtij paragrafi, tatimpaguesi dënohet me dyfishin e gjobës së parë.

Pas nenit 2 shtohet neni 3, që ka të bëjë me klauzolën transitore.

Kush është dakord me ndryshimin e nenit 2? Pastaj do të diskutojmë për masën e gjobës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e ke ndjekur. Ndryshimi që është bërë nuk është se është bërë tatimfitimi i thjeshtëzuar. Deri në 8 milionë lekë, është tatimfitimi i thjeshtëzuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kjo nuk ka lidhje me masën e taksës, por ka lidhje me mënyrën e deklarimit dhe ajo pjesë nuk është bërë tatimfitim i thjeshtëzuar, por thjesht i është ulur masa e taksës nga 14 milionë në 8 milionë.

Kush është dakord me formulimet? Pastaj do të vemi te masa e gjobës.

A është dakord ministria? Në rregull atëherë, ky nen kalon me riformulimin e komisionit. E hedhim në votim.

Unë do të bëj një propozim dhe më pas le ta gjykojë komisioni. Unë besoj se gjobat janë shumë të ngarkuara. Masat e këtyre gjobave na i ka kthyer mbrapsh edhe Gjykata Kushtetuese. Masa administrative e kërkesës për të hapur llogari, është e domosdoshme, duhet të mbështetet,

është detyrim ligjor dhe sigurisht, është bërë për arsye të dyfishta, që i thamë, por unë do të bëj propozimet e mia për masat e gjobës. Gjithmonë, kemi rënë dakord për teknikën ligjore, që të mos i hymë përsëri nga e para. Propozimi im për pikën “a” është 25 mijë lekë.

Propozimi im për pikën “b” është 50 mijë lekë dhe propozoj të përgjysmohet gjoja 75 mijë lekëshe e OJQ-ve. Besoj se duhet ta kemi parasysh edhe ngarkesën fiskale që ka çdo biznes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si thatë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne i bëmë komentet. Çfarë qëndrimi keni?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ne e votuam nenin 2 nga ana e teknikës legislative. Tani kemi vetëm shifrat. Keni ndonjë propozim për shifrat?

Senida Mesi – Kam nevojë për një sqarim në lidhje me logjikën e implementimit dhe vendosjes së gjobës, kryetar, pasi edhe ju më parë e përmendët, se kur flasim për vendosjen e gjobës, neni aktual 120 parashikon se për pagesat dhe arkëtimet me para në dorë mbi vlerën 150 mijë lekë gjobitet çdo subjekti me gjobë në masën 10% të vlerës së secilit transaksion.

Pra, nga njëra anë për çdo veprim që bëhet jashtë sistemit bankar për vlerat e detyrueshme që janë mbi 150 mijë lekë, do të gjobiten të gjithë me gjobë në masën 10% të vlerës së secilit transaksion.

Ndërkohë që ligji (kryetari e di mirë), parashikon jo në këtë nen, por në nenet e tjera dhe në ligjet e tjera, detyrimin për pagesën e shpenzimeve, si pagat që duhet të jepen nëpërmjet sistemit bankar, që të quhen transaksione apo shpenzime të zbritshme, nëse nuk kryhet si rezultat i këtij veprimi, përsëri është një gjobë për mosrealizimin e këtij veprimi. Domethënë, për çdo verim të munguar që duhet të kalojë me ligj në bankë, ne kemi detyrimet e përcaktuara qartë me gjobë.

Mbi këtë gjobë që i bie të jetë gjobë se nuk përdoret llogaria bankare, i bie që të kemi edhe një gjobë tjetër (nuk e di se si është menduar), vetëm për mospasjen e llogarisë bankare. Këtë desha të sqaroj unë, sepse po i gjobisim ...

Arben Ahmetaj – Po jua ritheksoj unë dhe besoj se edhe ministria do të më ndjekë dhe do të më mbështesë. Janë dy procedura të ndryshme. Praktikisht, njëra ka të bëjë me hapjen e llogarisë, tjetra ka të bëjë me transaksionet në *cash*. Ti mund të kesh llogari të hapur, por vazhdon të bësh transaksione në *cash* mbi nivelin e lejuar me ligj. Pra, duhet t’i mendojmë si dy procedura të ndryshme, që në finale bashkohen në një pikë të formalizimi të ekonomisë, por për shkak se janë procedura të ndryshme dhe shkelje të ndryshme procedurale do të kenë dy penalizime të ndryshme më vete. Harmonizimi është një element tjetër në të ardhmen, siç e thamë, por nga ana e procedurës

fiskale, të administrimit fiskal, procedurës tatimore dhe preventivimit të pastrimit të parave, duke i sjellë indirekt dhe direkt në kanalet bankare, automatikisht bëjmë edhe formalizimin e ekonomisë. Njëra është sjellja në shtratin bankar, tjetra që iu referuam është detyrimi që çdo transaksion mbi 1,5 milionë lekë të vjetra të jetë transaksion i sistemit bankar. Nga nesër e tutje mund ta ulim, në 1 milion apo në 500 mijë lekë të vjetra.

Të më falni që po flas me të vjetra për ta thjeshtuar për qytetarët!

Pra, jemi shumë të qartë, se është shumë e saktë. Ajo që unë kam merak është propozimi që bëra të cilin dua ta votoni, ndërsa pjesa e kërkesës për penalitetet e ndryshme për dy procedurat që janë fiskale dhe më tej, është e domosdoshme. Pra, besoj se ligji (ndryshimi), është i centruar më së miri.

Dua t'i referohemi propozimit që bëra.

Kush është pro propozimit që bëra për përgjysmimin e gjobave?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Kalojmë te neni 3, dispozitat transitore.

Kush është pro?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

Kur të mbarojë mbledhja, do t'i kërkonim ministres nga ana juaj...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një sekondë!

I lutem komisionit të fokusohet!

Zonjë, kur të dilni në korridor me profesor Anastasin, mund të diskutoni! Këtu jemi në komision.

Kush është pro nenit 3, që shtuam si procedurë transitore?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4, "Hyrja në fuqi".

"Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren zyrtare".

Kush është pro? Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin? Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund zonjë. Patjetër, në fund.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'ju kujtoj unë nëse harroni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni e falur, mund të ikni zonja Ministre!

Anila Denaj – Dua t'i përgjigjem tani zonjës, meqë për 15 minuta më duhet të shkoj në mbledhjen e qeverisë. Janë kolegët e ministrisë që do ta vazhdojnë ligjin e tretë, por janë 2 çështje shumë të rëndësishme, që u komentuan nga ju.

E para, kjo nuk ka të bëjë vetëm me një përqindje, siç tha zotëria, për luftën kundër terrorizmit, por ka të bëjë me reduktimin e ekonomisë informale dhe, pavarësisht se është brenda paketës MONEYVAL është shumë e rëndësishme të reduktohet ekonomia informale dhe përdorimi i *cash*-it, prandaj hapja e një llogarie është absolute, siç e përmendi edhe kryetari.

Si do të bëhet njoftimi?

Arben Ahmetaj – Më falni, Ministre, se e kemi votuar ligjin!

Nëse keni ndonjë shtesë të ligji i tretë.

Anila Denaj – Për ta theksuar më shumë, komunikimi do të bëhet nëpërmjet sistemit dhe me shërbimin e tatimpaguesit. Sistemi është shumë automatik dhe shumë i thjeshtë.

Arben Ahmetaj – Shumë e drejtë!

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësjë e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 05.06.2019, ora 11.00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Edlira Hyseni, Artemis Dralo (Malo), Anastas Angjeli, Blerina Gjylameti, Artur Roshi, Krenar Ryci

Mungojnë:

Nikolin Staka, Ervin Bushati, Reme Lala,

Të ftuar:

Anila Denaj - Ministre për Ekonominë dhe Financat

Elton Haxhi - Zëvendësministër për Ekonominë dhe Financat

Elvis Koci - Nga Ministria për Ekonominë dhe Financat

Niko Lera - Nga Ministria për Ekonominë dhe Financat

Agron Muslia - Nga Ministria për Ekonominë dhe Financat

Flogers Broqi - Nga Ministria për Ekonominë dhe Financat

Mikeljan Shkalla - Nga Ministria për Ekonominë dhe Financat

Arben Ahmetaj – Kalojmë te pika e tretë e rendit të ditës, te propozimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar””. Të mos harrojmë që për këtë ligj jemi komision për dhënie mendimi, nuk jemi komision përgjegjës. Komisioni përgjegjës është Komisioni i Ligjeve, kështu që...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi një mendim për të. Ju lutem, ma kaloni mendimin!

Unë po e lexoj mendimin. Zonja Ministre nuk keni nevojë të rrini, mund të largoheni.

Faleminderit!

Roland Xhelilaj – Kryetar, nuk do ta paraqesim opinionin për Komisionin e Ligjeve?

Arben Ahmetaj – Patjetër!

Ju lutem zoti Xhelilaj, keni fjalën si relator i komisionit për këtë projektligj.

Roland Xhelilaj – Duhet theksuar se ky projektligj vjen në kuadër të faktit që sistemi shqiptar i parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të raundit të pestë të vlerësimit për Shqipërinë i kryer nga Komiteti Moneyval i Këshillit të Europës 2, si struktura rajonale, që vlerëson për vendin tonë përputhshmërinë me rekomandimet e FATF-së. Në përfundim të vlerësimit nga ky komitet është konstatuar se pavarësisht zhvillimeve të konsiderueshme ligjore, vijohet të kihet boshllëqe.

Legjislacioni aktual në fuqi, pra ligji nr. 157/2013, nuk i përcakton siç duhet veprimet që duhen kryer nga subjektet raportuese në bazë të urdhrat të bllokimit. Përkufizimi i fondit dhe i pasurive nuk i përfshin pasuritë e trupëzuara dhe ato të patrupëzuara dhe nuk përfshin shprehimisht burimet ekonomike, duke bërë referencë vetëm te depozitat bankare.

Për sa më sipër, është vlerësuar se adresimi i problematikave të mësipërme duhet të realizohet ndërmjet përafrimit të legjislacionit për rekomandimet e Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar. Për këtë qëllim ligji synon zvogëlimin e rreziqeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit ndërmjet politikave, koordinimit dhe bashkëpunimit dhe parandalimit të hyrjes së produkteve të veprave penale dhe të veprimtarisë kriminale, si dhe të fondeve në mbështetje të terrorizmit në sektorin financiar apo në sektorë të tjerë ose zbulimin dhe raportimin e tyre, si dhe zbulimin dhe goditjen e kërcënimeve për pastrimin e parave për financimin e terrorizmit. Për këtë ka disa objektiva që do t'i trajtojë edhe Komisioni i Ligjeve.

Thelbësor është vijimi i përafrimit të legjislacionit. Parandalimi i ndërhyrjes së fondeve në mbështetjen e terrorizmit dhe zbulimi i pasurive, implementimi dhe zbatimi sanksioneve financiare specifike në përputhje me standardet e metodologjisë së Grupit të Posaçëm të Veprimit Financiar, bllokimi pa njoftim paraprak i fondeve dhe i pasurive të personave të shpallur, përcaktimi i mekanizmave për identifikimin e subjekteve potenciale për shpallje sipas kriterëve

të rezolutave dhe mundësinë e ndjekjes së procedurave dhe të formularëve standardë për listimin e miratuar nga strukturat përkatëse të Këshillit të Sigurimit, si dhe implementimin pa vonesë të sanksioneve financiare specifike dhe vendosjen e procedurave për heqjen nga lista dhe zhbllokim të fondeve dhe të pasurive të subjekteve, të cilat nuk e plotësojnë kriterin për shpallje.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Xhelilaj për referimin tuaj të saktë!

Për procedurë e votojmë në parim dhe më pas unë do të lexoj rekomandimet e komisionit tonë për Komisionin e Ligjeve. Do ta kalojmë nen për nen me ato rekomandime, nëse ju do të bini dakord.

Kush është dakord në parim?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Të gjithë janë pro. Miratohet në parim projektligji.

Kalojmë në votimin nen për nen. Unë do të lexoj për procedurë ndryshimet që ne i rekomandojmë komisionit përgjegjës dhe më tej, do të vazhdojmë duke i kaluar nenet një e nga një.

Në nenin 1 kudo në ligj fjalët: “ministri i Financave”, zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për financat”. Fjalët “ministri i Punëve të Jashtme” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për punët e jashtme”. Fjalët “ministri i Punëve të Brendshme” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për punët e brendshme”. Fjalët “ministri i Drejtësisë” zëvendësohen me fjalët “ministri përgjegjës për drejtësinë”.

I sugjerohet komisionit përgjegjës që në nenin 2 të projektligjit, që fjalët pas fjalës së parë në pikën 4, të nenit 6 të zëvendësohen me fjalët ...

Më falni!

Sugjeroj që herën tjetër Landi të vijë këtu, pas Anastasit.

I sugjerohet komisionit përgjegjës që në nenin 2 të projektligjit që fjalët pas fjalës së parë në pikën 4 të nenit 6, të zëvendësohen me fjalët në fund të pikës 4, të nenit 6 dhe të shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: ...

Në nenin 4 të projektligjit sugjeroj që t’i rekomandohet komisionit përgjegjës që të vlerësohet ruajtja e drejtë e balancës mes cenimit të së drejtës së përdorimit dhe gëzimit të lirisë së pronës e të drejtës për një proces të rregullt gjyqësor të individit me atë të interesit publik.

Sugjerojmë, gjithashtu, vendosjen e titullit të nenit 10/1, “Zbatimi i menjëhershëm i sanksioneve”.

Thënë kjo në këtë referencë ligjore, sipas neneve, kush është dakord me nenin 1 me sugjerimet për ndryshime?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2. Kush është dakord me sugjerimet dhe rekomandimet?

Kush është kundër? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3. Kush është dakord me sugjerimet dhe rekomandimet në këtë nen?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4. Kush është dakord me sugjerimet dhe rekomandimet?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 4.

Kalojmë te neni 10/1. Kush është dakord me këtë nen me sugjerimin e rëndësishëm, që i kemi bërë komisionit përkatës?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10/1.

Kalojmë te neni 5. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Kalojmë te neni 7. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 8.

Kalojmë te neni 9. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12. Kush është dakord?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 12.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord në tërësi me projektligjin?

Kush është kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi ky projektligj.

Faleminderit, anëtarëve komisionit!

Do të takohemi nesër.

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti